

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË SHA UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në SHA Ujësjellës Kanalizime Tiranë, me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare” për periudhën 01.01.2011 deri më 31.12.2013) dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 96 datë 01.08.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 325/10 datë 01.08.2014, dërguar Z. Fatbardh Islamaj, Drejtor i Ujësjellës Kanalizimeve Tiranë, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

I. Mbi realizimin e programit ekonomiko-financiar:

U konstatua:

-Projektprogrami ekonomik dhe financiar për vitin 2012, është shqyrtuar me vonesë në Këshillim Mbikëqyrës dhe nuk është miratuar në Asamblenë e Aksionarëve.

- Nuk janë miratuar ndryshimet në planin e zhvillimit për vitin 2012, në Këshillin Mbikëqyrës dhe nuk janë ndjekur të njëjtat procedurë si në rastin e miratimit të programit fillestar të shoqërisë, veprime këto në kundërshtim me pikën 7, të Rregullores së Brendshme të UKT sh.a, Kreu II, “Miratimi i Programit ekonomik të zhvillimit”. Gjithashtu nuk janë reflektuar ndryshime në zërat e shpenzimeve në programin ekonomik të vitit 2012.

- Raportimet mbi realizimin e treguesve ekonomik e financiar që paraqiten në këshillin drejtues të shoqërisë, janë të vakta, vetëm me të dhëna në tabela, pa analiza të hollësishme mbi shkaqet dhe faktorët që kanë ndikuar në arritjen e objektivave të shoqërisë, për pasojë nuk janë evidentuar personat përgjegjës, si dhe nuk janë propozuar masat për të rregulluar gjendjen në të ardhmen.

- Treguesit e performancës të shoqërisë për raportet prodhim-furnizim-shpërndarje-faturim, dhe faturim-arkëtim, janë realizuar me të ulëta në krahasim me treguesit e planifikuar, për arsye se; megjithëse sasia e ujit të prodhuar megjithëse është me tejkalim në masën 5% në krahasim me planin, kjo gjë nuk ka dhënë efekte pozitive në të ardhura pasi totali i ujit të faturuar kanë rënë në masën 9% në krahasim me planifikimin. Po kështu janë rritur humbjet e ujit në rrjet në masën 163.63%, si pasojë e keq menaxhimit të matjes së sasisë së ujit të prodhuar, që rezulton me mosrealizim në faturim, dhe nga rritja e sasisë së ujit të ndotur në rrjet;

- Grupi i punës nuk ka paraqitur draftin për planin e masave sipas afatit të përcaktuar në urdhrin e brendshëm të Drejtorit të Përgjithshëm të UKT sh.a, si dhe nuk është miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i UKT sh.a. , veprim ky në kundërshtim me ligjin nr.9901, datë 14.04.2008, me neni 23 të Statusit dhe me Rregulloren e Brendshme të shoqërisë.

- Nuk janë realizuar investimet e planifikuara për vitet 2012 dhe 2013, gjë e cila ka dhënë ndikim të drejtpërdrejtë në të ardhurat e shoqërisë. Strukturat drejtuese të shoqërisë kanë lejuar të bëhen parashikime për investime të pastudiuara mirë duke mos pasur parasysh dhe mundësitë financiare të shoqërisë. Për këtë në Këshillin Mbikëqyrës të UKT sh.a, nuk janë bërë analiza të hollësishme mbi ndikimin që do të japin investimet në përmirësimin e të ardhurave dhe impaktin e tyre në to.

- Ka pasaktësi në përlllogaritjen e sasisë së ujit që humbet nga lidhjet e paligjshme që janë në rrjetin aktual që administrohet nga shoqëria, pasi janë futur në humbje dhe shpërdorimet e ujit nga lidhjet e paligjshme dhe nga mosfaturimi i ujit të cilat janë konsideruar si humbje tekniko-ekonomike;
- Nuk janë evidentuar klientët konsumatorë të ujit, që kanë ndërtuar shtëpitë e banimit pranë linjave të transmetimit dhe për këtë nuk është bashkëpunuar me ALUIZMI-n, në procesin e legalizimit, për të vendosur kushte për marrjen e lejes së legalizimit nga banorët të marrin vërtetim për pajisjen me kontaktorë nga UKT sh.a;
- Ka pasaktësi në sasinë e ujit të prodhuar, pasi prodhimi vlerësohet me kapërdredhësa;
- Nuk ka tregues për monitorimin periodik për ndjekjen e nivelit të arkëtimit, me qëllim përmirësimin e treguesve cilësor të faturim-arkëtimeve, si dhe nuk janë shfrytëzuar të gjitha burimet njerëzore në rritjen e faturimit të ujit dhe në përmirësimin e cilësisë së ujit të konsumatorët;
- Shpenzimet për mirëmbajtje dhe riparime nga të tretë, janë tejkaluar në vitin 2012 dhe 2013, kjo ka ardhur si pasojë se shoqëria përsërit të njëjtin fenomen, duke kontraktuar për rikonstruksioneve dhe investime të reja në rrjetin ujësjellës-kanalizime, me kompani të pa specializuara për kthimin e asfaltit të rrugëve në gjendjen e tyre të mëparshme.
- Për vitin 2012, nga sasia totale e ujit të prodhuar në sistem për 104,718,787 m³, nuk janë faturuar 50,428,787 m³, e cila e vlerësuar me kosto prodhimi për njësi (për 5.512 lekë/m³), rezulton në shumën 277,9 milion lekë. Kjo është një e ardhur e munguar për shoqërinë, me ndikim drejtpërdrejtë në performancën e treguesve ekonomik e financiar për vitin 2012.
- Për vitin 2013, nga sasia e ujit të prodhuar në sistem për 108,912,439 m³, nuk janë faturuar 53,758,716 m³ ujë, vlerësuar me kosto prodhimi për njësi (për 4.677 lekë/m³), rezulton me shumën 251.42 milion lekë. Kjo vlerë është e ardhur e munguar në rezultatin financiar të shoqërisë, me ndikim të drejtpërdrejtë në performancën e treguesve ekonomik e financiar të shoqërisë, duke ngarkuar me përgjegjësi strukturat drejtuese të shoqërisë, të cilat nuk kanë menaxhuar si duhet gjithë procesin që nga prodhimi i ujit deri te konsumatori i fundit, me qëllim rritjen e performancës së shoqërisë për të përmirësuar cilësinë dhe sasinë e ujit që prodhohet dhe realizimin e objektivave kryesore.
- Janë rënduar në mënyrë të padrejtë shpenzimet e shoqërisë, për vlerën e mjeteve kryesore rikupero në shumën 817,618 lekë, pasi nuk janë kthyer në magazinën rikupero, duke sjellë efekte negative në rezultatin financiar për vitin 2012.
- Si pasojë e parregullsive dhe pasaktësive në dokumentacion e pagesave me bankë dhe pas verifikimit në terren të punimeve të kryera konstatohet se, firma zbatuese [REDAKTUAR] sh.p.k., ka përfituar më tepër në mënyrë të padrejtë për punime të pa kryera të certifikuara nga mbikqyrësi i punimeve, ***në vlerën 2,488,088 me TVSh, duke shkaktuar një dëm ekonomik për UKT sh.a.*** Këto veprime janë në papajtueshmëri me paragrafin e tretë të nenit 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, në kundërshtim me Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.3, datë 15.02.2001, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika 17, për parregullsitë në dokumentacionin të pagesave me bankë janë në kundërshtim me nenin 12 “Përgjegjshmëri menaxheriale e nëpunësit zbatues”, pika (e) dhe (dh), të ligjit nr.10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, dhe me pikën 35, kapitulli “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve”, të Udhëzimit nr 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Për eliminimin e këtyre shkeljeve dhe parregullsive rekomandojmë:

Për këshillin Mbikëqyrës të Ujësjellës Kanalizime, Tirane:

1. Këshilli Mbikëqyrës në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshëm të marrin masa për të përmirësuar treguesit e performancës të shoqërisë për raportet prodhim-furnizim-shpërndarje-faturim, dhe faturim-arkëtim, të cilat janë realizuar me të ulëta në krahasim me treguesit e planifikuar, duke administruar vëllimin e ujit të prodhuar, rritjen e faturimit të ujit, me qëllim uljen e humbjeve të ujit në rrjet.

Vazhdimisht

2. Këshilli Mbikëqyrës në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshëm të marrin masa për të analizuar punën e departamentit të investimeve në lidhje me realizimin dhe planifikimin e investimeve, me qëllim për të orientuar investimet e shoqërisë drejt përmirësimit të rrjetit të ujësjellësve në qytetin e Tiranës, për furnizimin me ujë të popullatës dhe uljen e humbjeve të ujit në rrjet.

Vazhdimisht

3. Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë dhe Asambleja e Aksionarëve, të marrin masa me qëllim për të siguruar fonde për investime për vendosjen e matësve në të gjitha pikat e prodhimit të ujit, pasi aktualisht prodhimi vlerësohet me kapërdredhësa.

Vazhdimisht

4. Këshilli Mbikëqyrës të marrë në analizë Departamentin e Shitjes për problemet e faturimit, arkëtimit, lidhjen e kontratave të reja, duke synuar në përmirësimin e këtyre treguesve si dhe realizimin e objektivave të programuara, si dhe vendosjen e treguesve të monitorimit periodik për ndjekjen e nivelit të arkëtimit të ujit nga konsumatorët.

Vazhdimisht

5. Këshilli Mbikëqyrës dhe Asambleja e Aksionarëve të marrë në analizë punën e departamenteve të shoqërisë, me qëllim përmirësimin e treguesve të performancës për raportet: prodhim-faturim, faturim-arkëtim dhe eliminimin e të ardhurave të munguara të shoqërisë, për të realizuar përmirësimin e situatës financiare të shoqërisë dhe uljen e humbjeve në rrjet.

Për Drejtorinë e Ujësjellës Kanalizime, Tirane:

1. Drejtoria Ekonomike të marrë masa për të kaluar me procedurë në organet drejtuese të shoqërisë, ndryshimet në programet ekonomike gjatë vitit, dhe të bëjë reflektimet përkatëse të shifrave në planin fillestar.

Vazhdimisht

2. Drejtoria Ekonomike të marrë masa në të ardhmen për të paraqitur në Këshillin Drejtues të shoqërisë, raportimet mbi realizimin e treguesve ekonomik e financiar, të jenë të plota, të shoqëruara me relacione, duke analizuar të dhënat historike mbi realizimin e treguesve tekniko ekonomik të shoqërisë, shkaqet dhe faktorët që kanë ndikuar në arritjen e objektivave të shoqërisë, duke evidentuar mangësitë dhe propozuar masat për të rregulluar gjendjen në të ardhmen.

Vazhdimisht

3. Të merren masa, për të paraqitur në Këshillin Mbikëqyrës të shoqërisë, kërkesat për shtesat në numrin mesatar të punonjësve të shoqërisë, të shoqërohen edhe me efektet financiare, të cilat do të ndikojnë drejtpërdrejtë në rritjen e shpenzimeve për fond page, sigurime shoqërore dhe tatim mbi page.

Vazhdimisht

4. Të merret në analizë puna e Departamentit Inxhinierik për problemet që lidhen me saktësinë e përqindjeve të humbjeve të ujit të rrjetin e ujësjellsave, duke kërkuar që të bëhen studime të thelluara me grupe pune, me specialistë të fushës, me qëllim që humbjet nga lidhjet e paligjshme që janë në rrjetin aktual që administrohet nga shoqëria, dhe shpërdorimet e ujit nga lidhjet e paligjshme dhe nga mosfaturimi i ujit, të mos konsiderohen më si humbje tekniko-ekonomike.

Menjëherë

5. Të merren masa që të evidentojnë klientët konsumatorë të ujit, që kanë ndërtuar shtëpitë e banimit pranë linjave të transmetimit, duke synuar bashkëpunimin me ALUIZMI-n për t'u përfshirë në procesin e legalizimit, duke bërë përmirësime ligjore, me vendosjen e kushteve shtesë për marrjen e lejes së legalizimit nga banorët, që të pajisjen me vërtetim për kontaktorë nga UKT sh.a.

Menjëherë

6. Të merren masa për të bërë identifikimin e të gjithë abonentëve familjarë, privatë, institucioneve buxhetore, dhe jo buxhetore etj, me qëllim përcaktimin e vendndodhjeve të tyre sipas zonave ku gjenden, për të pajisur me matësa të gjithë abonentëve që furnizohen me ujë nga rrjeti i Ujësjellës Kanalizime sh.a Tiranë, për të minimizuar numrin e abonentëve me faturim afrove.

Menjëherë

7. Departamenti Ekonomik në bashkëpunim me Departamentin Inxhinierik të marrin masa për të planifikuar saktë shpenzimet për mirëmbajtje dhe riparime nga të tretë, për rikonstruksionet dhe investime të reja në rrjetin e ujësjellës-kanalizime, me qëllim që kompanitë që do të kontraktohen nga shoqëria për rikonstruksione në rrjetin e ujësjellësve, të jenë të specializuara për kthimin e asfaltit të rrugëve në gjendjen e tyre të mëparshme.

Vazhdimisht

8. Departamenti Ekonomik të marrë masa për të kryer veprimet e kontabël për të sistemuar në kontabilitet vlerën e mjeteve kryesore rikupero në shumën 817,618 lekë, pasi janë rënduar në mënyrë të padrejtë shpenzimet e shoqërisë në rezultatin financiar për vitin 2012.

Menjëherë

II. Mbi procedurat e prokurimit .

U konstatua:

Ne shumicen e procedurave të realizuara si në vitin 2012 dhe në vitin 2013 kanë dale fitues operatorët ekonomik që kanë paraqitur ofertat me vlera më të vogël ekonomike. Por u konstatuan edhe raste skualifikimit të disa operatorëve ekonomikë të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike me vlera më të ulta se fituesit. Skualifikimet e këtyre operatorëve janë bërë nga KVO sepse në dokumentacionin teknik të tyre kanë pasur disa mangësi në lidhje me plotësim të disa kërkesave të veçanta të vendosura në Dokumentet e Tenderit nga Autoriteti Kontraktor. Mirëpo KVO-te në zbatim të pikës 1 dhe 4 të nenit 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik" duhej të kërkonin këtyre operatorëve ekonomik sqarime për këto mangësi, për të shqyrtuar dhe krahasuar ofertat e tyre sa më drejtë në raport me ofertat e tjera.

Mbas shqyrtimit te këtyre sqarimeve nëse mangësitë do te rezultojnë devijime të vogla dhe mund të korrigjoheshin pa prekur përmbajtjen e kontratës; nisur nga ofertat me leverdishme ne tender munde te shpallte fitues këta operatore.

Për eliminimin e kësaj parregullsie rekomandojmë:

Drejtorinë e Ujësjetllës Kanalizime, Tirane me cilësinë e Autoritetit Kontraktor ne ato raste kur konstaton mangësi ne dokumentacionin teknik te operatoreve pjesëmarrës ne procedurat e prokurimit, ne zbatim te pikës 1 dhe 4 të nenit neni 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” duhej ti kërkojnë këtyre operatorëve ekonomik sqarime për këto mangësi, për te shqyrtuar dhe krahasuar ofertat e tyre sa më drejtë në raport me ofertat e tjera.

Vazhdimisht

III. Mbi zbatimin e punimeve:

U konstatua:

- Ne disa objekte te audituara u konstatuan punime me cilësi te dobët dhe jashtë kushteve teknike. Konkretisht ne objektet: “Mbrojtje lumore në lumin Erzen”, “Ndërtimi rrjet i ri shpërndarës Ujësjetllësi në rrugën Islam Rusi-Shkozë” “Ndërtimi i Rrjetit të Ujësjetllësit në Rrugën e Dibrës” Tiranë, “Ndërtimi i Rrjetit të Ujësjetllësit në Rrugën e Dibrës” Tiranë “Ndërtimi i Rrjetit të Ujësjetllësit në Rrugën e Dibrës”.

Për eliminimin e këtyre parregullsive rekomandojmë;

1. Të merren masa, për riparimin e dëmtimeve të konstatuara në shtresën e betonit në panelin nr. 4, kati 5, brenda periudhës së garancisë, dhe në zbatim të kontratës se sipërmarrjes nr.864/8, datë 29.04.2013, neni 22, në lumin “Erzen” në zbatim të kontratës me Operatorin Ekonomik [REDAKTUAR] sh.p.k për ndërtimin e “Mbrojtje lumore në lumin Erzen” Tiranë.

Menjëherë

2. Të merren masa për riparimin në linjën e tubacionit me Dj-110 mm, të shtresës së binderit të dëmtuar për gjatësinë 52 ml, në volumin 52 m² si dhe të shtresës asfalt-beton për 52 ml në volumin 52 m² të dëmtuar, në zbatim të kontratës me Operatorin Ekonomik [REDAKTUAR] sh.p.k për ndërtimin e “Ndërtimi rrjet i ri shpërndarës Ujësjetllësi në rrugën Islam Rusi-Shkozë” Tiranë.

Menjëherë

3. Të merren masa për riparimin në linjën e tubacionit me Dj-110 mm në rrugën “Feim Ibrahim” të shtresës binder për gjatësinë 115 ml me gjerësi 1 m, si dhe 115 m² asfaltobeton, në zbatim të kontratës me Operatorin Ekonomik [REDAKTUAR] sh.p.k për ndërtimin e “Ndërtimi rrjet i ri shpërndarës Ujësjetllësi në rrugën Islam Rusi-Shkozë” Tiranë.

Menjëherë

4. Të merren masa për riparimin e kunetës së dëmtuar në krahun e majtë të rrugës “Feim Ibrahim” për gjatësinë 115 ml me gjerësi 0.5 m, ose 10.07 m³, në zbatim të kontratës me Operatorin Ekonomik [REDAKTUAR] sh.p.k për ndërtimin e “Ndërtimi rrjet i ri shpërndarës Ujësjetllësi në rrugën Islam Rusi-Shkozë” Tiranë.

Menjëherë

5. Të merren masa për vendosjen e kasetave metalike për 110 copë deri në marrjen në dorëzim të objektit, në zbatim të kontratës me Operatorin Ekonomik [REDAKTUAR] sh.p.k për ndërtimin e “Ndërtimi rrjet i ri shpërndarës Ujësjetllësi në rrugën Islam Rusi-Shkozë” Tiranë.

Menjëherë

6. Të merren masa për të riparuar të gjitha dëmtimet e shtresave asfaltike, binder dhe asfaltobeton për 10 m2, në rrugën “Dibër”, në zbatim të kontratës me Operatorin Ekonomik [REDACTED] sh.p.k për ndërtimin e “Ndërtimi i Rrjetit të Ujësjellësit në Rrugën e Dibrës” Tiranë.

Menjëherë

7. Të merren masa për të riparuar pusëtën tek “Hotel Vjosa” në rrugën “Dibër”, në zbatim të kontratës me Operatorin Ekonomik [REDACTED] sh.p.k për ndërtimin e “Ndërtimi i Rrjetit të Ujësjellësit në Rrugën e Dibrës”, Tiranë.

Menjëherë

8. Të merren masa për të riparuar pusëtën tek “Medreseja” në rrugën “Dibër”, në zbatim të kontratës me Operatorin Ekonomik [REDACTED] sh.p.k për ndërtimin e “Ndërtimi i Rrjetit të Ujësjellësit në Rrugën e Dibrës” Tiranë.

Menjëherë

IV. Mbi shpenzimet e kryera nëpërmjet bankës.

U konstatua:

- Njësia e prokurimit për vitin 2012 nuk ka përfshirë në regjistrin e parashikimit të dërguar në APP prokurimet me vlerë të vogël në bazë të nevojave për mallra dhe shërbime në kundërshtim me pikën 3/b të Kreut I dhe pikës 2/a Kreu i VI në VKM nr 1 datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar dhe Udhëzimi i Agjencisë së Prokurimit Publik nr.28 datë 18.02.2008 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla.

- Janë kryer pagesa për blerje me vlera të vogla për mallra e shërbime në 13 raste në vlerën 1,388,340 lekë, ku komisioni ka bërë blerje të mallrave dhe shërbimeve mbi sasinë e përcaktuar në Urdhër Prokurim në kundërshtim me pikën 2 Kreu i VI në VKM nr 1 datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar dhe Udhëzimi i Agjencisë së Prokurimit Publik nr.28 datë 18.02.2008 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”.

- Nga blerjet e mësipërme është kryer pagesë në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme, me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 12 “Përgjegjshmëria menaxheriale nëpunësve zbatues” pika(dh)(ë) me *pasojë dëmin ekonomik në shumën prej 480,000 lekë* për shërbimin “Për hartimin dhe paraqitjen e raportit financiar të vitit 2011”.

- Është likuiduar operatori ekonomik [REDACTED] shpk për blerjen e artikullit “Program i kompjuterizuar për llogaritjen e pagave”, programi i cili, nuk është bërë hyrje në magazinë dhe nuk ekziston i instaluar në sistemin informatik të institucionit në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 12 pika (f) dhe me UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 10 dhe Kapitulli “Dokumentimi lëvizjes së aktiveve” pika 34,35/b,37 me *pasojë dëmin ekonomik në vlerën 380,000 lekë*.

- Nga auditimi i realizimit të prokurimeve me vlera të vogla u konstatua se për të dy vitet ka tejkalim të kufirit monetar vjetor prej 400,000 lekësh të blerjes me këtë procedurë për atikull dhe grup artikujsh mallrash dhe shërbimesh në kundërshtim me Udhëzimit të APP nr. 2, datë 18.02.2008 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla” të ndryshuar, pika 1, 2,3 dhe me pikën 2/a Kreu i VI në VKM nr 1 datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Nga analiza e artikujve dhe të grup artikujve të blerë me këtë procedurë rezulton se:

-Për vitin 2012 janë bërë blerje në vlera të konsiderueshme me procedurën e prokurimit me vlera të vogla në vlera të konsiderueshme për grup artikujt, pa zbatuar procedurat e tenderimit, si: “Materiale hidraulike” në shumën 62,369,976 lekë, “pjesë këmbimi e shërbime për automjete” në shumën 9,755,040 lekë, “materiale elektrike” në vlerën 13,101,092 lekë, “kancelari” në shumën 2,633,355 lekë, “materiale ndërtimi” në shumën 2,548,000 lekë, etj.

Tejkalimi i kufirit monetar prej 400,000 lekësh për një vit kalendarik ka ndodhur edhe për raste të blerjes të një artikulli si për shembull në 10 raste të analizuara në shumën 14,080,222 lekë.

Ka raste të blerjeve me procedurat e prokurimit me vlera të vogla, ku malli apo shërbimi është një e tërë, por blerja është kryer me 2 procedura prokurimi për një objekt, duke copëtuar fondin, si për shembull për 3 raste në shumën 2,311,590 lekë.

- Janë kryer blerje me procedurat e blerjeve me vlera të vogla për shërbimin “hartim dhe përgatitje të projekt-studimeve teknike” për investime të kryera në objekte të ndryshme në vlerë totale 3,330,000 lekë. Kjo vlerë e tejkalon kufirin monetar prej 400,000 lekë, të lejuar për prokurim me këtë procedurë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenit 13, VKM nr. 1 datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar Kreu i VI pika 2/a “Prokurimi me vlera të vogël”, pika 3 “Shërbimet e konsulencës” dhe Udhëzimit të APP nr. 2, datë 18.02.2008 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla” të ndryshuar. Këto projekte nuk janë bërë hyrje në magazinë në kundërshtim me ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 12 dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve”

- Janë kryer pagesa në 6 raste në vlerën 752,836 lekë për blerje mallra dhe shërbime, për të cilat e ekziston Urdhër-prokurimi por mungojnë praktikat e procedurave të prokurimit të blerjeve me vlera të vogla, ose kanë mangësi në procedura në kundërshtim me VKM nr. 1 datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VI pika 2 dhe Udhëzimit të APP nr. 2, datë 18.02.2008 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla” të ndryshuar. Nga Kryetari i Degës së Financës janë pranuar dokumentacioni me shkelje, pa u kundërshtuar apo pa e dhënë opinionin ligjor në mënyrë shkresore pranë Drejtorit të Përgjithshëm para likuidimit të tyre. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 12 pika (a), (e) dhe (f), neni 13, 14, 15, 22, me Udhëzimin e MF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve” pika 35/a, b dhe Urdhrin e MF nr. 92 datë 29.12.2011 “Për gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

- Janë kryer pagesa në 2 raste me pasojë dëmin ekonomik në shumën 615,000 lekë për blerje mallra dhe shërbime, ku mungon kërkesa që përcakton nevojat, urdhër prokurimi për blerjen e këtyre mallrave dhe praktikat e procedurave të prokurimit të blerjeve me vlera të vogla, ose kanë mangësi në procedura në kundërshtim me VKM nr. 1 datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VI pika 2 dhe Udhëzimit të APP nr. 2, datë 18.02.2008 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla” të ndryshuar. Nga Kryetari i Degës së Financës janë pranuar dokumentacioni me shkelje, pa u kundërshtuar apo pa e dhënë opinionin ligjor në mënyrë shkresore pranë Drejtorit të Përgjithshëm para likuidimit të tyre. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 12 pika (a), (e) dhe (f), neni 13, 14, 15, 22, me Udhëzimin e MF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve” pika 35/a, b.

- Në bazë të Urdhrit të Brendshëm nr. 326 datë 26.12.2012 “Për dhënie shpërblimi me rastin e festave të fundvitit 2012” janë kryer shpenzime për shpërblim në fund të vitit, për 6 anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës dhe sekretarin e tij, në kundërshtim me Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” të ndryshuar neni 160 “shpërblimi” pika 1 dhe neni 167 pika 5 dhe nenin 13 të Statutit të Shoqërisë, me nenin 12 pika (a)(e) dhe nenin 13 të ligjit nr. 10296 datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, VKM nr. 642 datë 11.10.2005 “Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore” dhe Udhëzimit të METE nr. 318 datë 08.04.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës në Shoqëritë Anonime Shtetërore” me pasojë dëmin ekonomik në shumën 161,000 lekë.

Për eliminimin e këtyre shkeljeve dhe parregullsive rekomandojmë:

1. Të merren masa që procedurat e prokurimit “Blerje me vlera të vogla”, të bëhen vetëm mbi bazën me një argumentimi ligjor për domosdoshmërinë e përdorimit të kësaj procedure.

Vazhdimisht

2. Për çdo rast të ngrejë komisione me specialistë dhe ekspertë të fushës, për kolaudimin dhe marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, në mënyrë të veçantë kontratave për mallra dhe shërbime specifike.

Vazhdimisht

V . Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm.

U konstatua

-Për vitet 2012-2013 sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit i mungon një plan i mirëfilltë i zhvillimit si dhe përcaktimi i metodologjisë për zbatimin e tij. Nuk është hartuar një plan-veprimi ku të jenë përcaktuar konkretisht veprimet që do të merren qëllimi, afatet e realizimit dhe personat përgjegjës.

-Për vitin 2012 nuk është përgatitur dhe dërguar pranë Njësisë Qendrore të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Ministrisë së Financave, “Deklarata e cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm, raporti vjetor për cilësinë e kontrollit të brendshëm dhe pyetësorin e vetëvlerësimit të komponentëve të MFK për vitin 2011” në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 28, datë 15.11.2008, “Mbi paraqitjen e Deklaratës dhe Raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike” pika 17.

- Për vitet 2012 dhe 2013 nuk ka pasur të përcaktuar kordinator risku bashkë me detyrat e tij. Nuk ka të miratuar një strategji konkrete të risqeve.

- Nuk është hartuar regjistri të riskut, ku të jenë përcaktuar nivelet e riskut para kontrollit dhe pas kontrollit sipas fushave të përcaktuara. Nuk ka asnjë procedurë për menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi paraprak, raportimi, analiza e risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.

- Nuk ka sistem monitorimi për vlerësimin e efektivitetit dhe progresit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm për arritjen e objektivave.

- Nuk ka informacion të vazhdueshëm për Titullarin dhe menaxherët e programeve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti. Nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave.

Për eliminimin e këtyre shkeljeve dhe parregullsive rekomandojmë:

1. Te hartohet plani për ngritjen e sistemit të menaxhimit financiar, planin strategjik, të përcaktohen objektivat, si dhe të hartohen plan-veprimet afatshkurtra për implementimin e Ligjit nr. 10.296, datë 08.7.2010 “Për

menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Menjëherë

2. Të kryhen kualifikime nëpërmjet trajnimeve brenda dhe jashtë institucionit për mënyrën e analizës së menaxhimit të riskut, për t’u njohur më mirë me konceptet e ligjit, si dhe komponentët e MFK për të gjithë menaxherët e shoqërisë, më qëllim implementimin dhe zbatimin sa më të mirë të tyre në praktikë.

Vazhdimisht

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Të kërkohej në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe shkallët e gjykimit, arkëtimi i shumës gjithsej **2,488,088 lekë me TVSH**, nga firma zbatuese ““■■■■””, sh.p.k., e cili e ka përfituar këtë shumë në mënyrë të padrejtë për punime të pa kryera të çerfikuara nga mbikqyrësi i punimeve, në kundërshtim me paragrafin e tretë të nenit 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, me pikën 17 të Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 3, datë 15.02.2001, ”Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, me neni 12 “Përgjegjshmëri menaxheriale e nëpunësit zbatues”, pika (e) dhe (dh), të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, dhe me pikën 35, kapitulli “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve”, të Udhëzimit nr 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Menjëherë

2. Nga Sh.a Ujësjetllës kanalizime Tiranë të kërkohej në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës 524.641 lekë (me t.v.sh), duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për Operatorin Ekonomik ““■■■■”” sh.p.k të cilën e ka përfituar tepër për punime të pakryera në tenderin me objekt “Ndërtimi rrjet i ri shpërndarës Ujësjetllësi në rrugën Islam Rusi - Shkozë ” Tiranë.

Menjëherë

3. Nga Sh.a Ujësjetllës kanalizime Tiranë të kërkohej në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës 587.784 lekë (me t.v.sh), duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për Operatorin Ekonomik ““■■■■”” sh.p.k të cilën e ka përfituar tepër për punime të pakryera në tenderin me objekt “Përmirësim i furnizimit me ujë i bllokut që kufizohet nga “Siri Kodra”, “Ramazan Bogdani”, “5-Maji” dhe e Nënstacionit elektrik ” Tiranë.

Menjëherë

4. Nga Sh.a Ujësjetllës kanalizime Tiranë të kërkohej në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës 420.238 lekë(me t.v.sh), duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për Operatorin Ekonomik ““■■■■”” sh.p.k të cilën e ka përfituar tepër për punime të pakryera në tenderin me objekt “Ndërtimi i Rrjetit të Ujësjetllësit në Rrugën e Dibrës”,Tiranë.

Menjëherë

5. Mbështetur në ligjin nr. 8485,datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, kreu I, nenet 105-109 dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kap IV “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve”pika 93, nga Administratori i Shoqërisë “UKT”sh.a (Nëpunësit Autorizues), të

nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin dhe të kryejë regjistrimet e nevojshme kontabile përfundimtare me qëllim evidentimin dhe njohjen e shpërblimit dëmit në vlerën 2,004,099 lekë, si më poshtë:

a. Vlera 748.099 lekë në ngarkim të z. [REDAKTUAR] z. [REDAKTUAR] dhe z. [REDAKTUAR] e shpenzuar më tepër në 12 raste për blerje me vlera të vogla për mallra e shërbime mbi sasinë e përcaktuar në Urdhër Prokurim në kundërshtim me të VKM nr 1 datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, Kreu i VI pika 2 dhe Udhëzimin e APP nr.28 datë 18.02.2008 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”.

Menjëherë

b. Vlera 480,000 lekë në ngarkim të znj. [REDAKTUAR] me detyrë Kryetare e Degës së Financës për pagesën e shërbimit “Për hartimin dhe paraqitjen e raportit financiar të vitit 2011” në kundërshtim me Rrregulloren e Brendshme të UKT dhe me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 12 “Përgjegjshmëria menaxheriale nëpunësve zbatues” pika(dh)(ë).

Menjëherë

c. Vlera 615,000 lekë në ngarkim të znj. [REDAKTUAR] me detyrë ish-Kryetare e Degës së Financës dhe në cilësinë e nëpunësit zbatues e cila ka likuiduar operatorin ekonomik “[REDAKTUAR]” për blerje “kaseta sahati uji” sipas faturave të parregullta, në mungesë të Urdhër Prokurimit dhe procedurës së prokurimit të kësaj blerjeje në kundërshtim me VKM nr. 1 datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VI pika 2 dhe Udhëzimit të APP nr. 2, datë 18.02.2008 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla” të ndryshuar dhe Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 12 pika (a),(e) dhe(f), neni 13,14,15,22, me Udhëzimin e MF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve” pika 35/a,b, pasi nga Kryetari i Degës së Financës janë pranuar dokumentacioni me shkelje, pa u kundërshtuar apo pa e dhënë opinionin ligjor në mënyrë shkresore pranë Drejtorit të Përgjithshëm para likuidimit të tyre.

Menjëherë

ç. Vlera 161,000 lekë, përfituar padrejtësisht shpërblim në fund të vitit nga 7 anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës dhe sekretari i tij në kundërshtim me Ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” të ndryshuar neni 160 “shpërblimi” pika 1 dhe neni 167 pika 5 dhe nenin 13 të Statutit të Shoqërisë, me nenin 12 pika (a)(e) dhe nenin 13 të ligjit nr.10296 datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, VKM nr.642 datë 11.10.2005 “Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore” dhe Udhëzimit të METE nr.318 datë 08.04.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës në Shoqëritë Anonime Shtetërore” Detyrimi për t’u kthyer nga përfituesit me pa të drejtë të këtij shpërblimi paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr	Dokumenti i Bankës		Emër Mbiemër	Shuma në lekë
	Nr	Datë		
1	1661	28.12.2012	[REDAKTUAR]	23,000
2	1662	28.12.2012	[REDAKTUAR]	12,000
3	2570	28.12.2012	[REDAKTUAR]	34,500
4	2571	28.12.2012	[REDAKTUAR]	23,000
5	2572	28.12.2012	[REDAKTUAR]	23,000

6	2573	28.12.2012	.		23,000
7	2574	28.12.2012	.		23,000
			T O T A L I		161,500

Menjëherë

Shënim: Auditimi i krye nga audituesit Bashkim Arizaj, Luljeta Shtylla, Irma Shkupi, Skënder Muça, më tej u shqyrtua nga k/auditues Mimoza Lloji, Drejtori i Departamentit Xhaferr Xhoxhaj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Ermal Yzeiraj, si dhe u verifikua si praktike nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT